

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6656
E hënë, 18 korrik 2022
çmimi 0.40

Britania: Ruisë i janë vrrarë dhe plagosur 50 000 ushtarë në Ukrainë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË OPOZITARE VAZHDOJNË TA KRITIKOJNË QEVERINË KURT
NË RAPORT ME GJENDJEN NË VEND | FAQE 4-5

OPOZITA: KOSOVA ËSHTË NË KRIZË SHUMË TË THELLË



Përfaqësuesit e partive politike, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë theksuar se Kosova është në ditët më të vështira të stresit social dhe ekonomik që nga paslufta. Memli

Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Besnik Tahiri kanë thënë se kryeministri Kurti nuk njeht rritjen e çmimeve e vështirësitë e familjeve në vend. Sipas tyre, Kosova është në krizë shumë më të thellë se çdo shtet evropian, pasi nuk kemi qeveri që u del në krah qytetarëve të saj


AKTUALE



EVROPA VAZHDON TË PËRBALLET
ME ZJARRE | F. 2

ZBULOHEN PLLAKAT NË SHITËPITË
QË KANË QENË BAZA DHE
NË SHËRBBIM TË UÇK-së | F. 6

ARSIM BAJRAMI VIZITON KRERËT E
UÇK-së NË HAGË: NJË BETEJË E
FORTË LIGJORE PO NA PRET | F. 6



EKONOMI



E VËRTETA MBI ZBULIMIN E NAFTËS
DHE GAZIT NË SHQIPËRI | F. 8

SPORT



GJYQATARËT E KOSOVËS DELEGOHEN
PËR NDESHJEN E LIGËS SË
KONFERENCËS | F. 12



LËNDOHEN PESË ZYRTARË POLICORË GJATË NJË AKSIONI KUNDËR KONTRABANDËS ME MALLRA NË VERI

FAQE 5



MË 15 GUSHT NIS GARA PËR KRYETARIN E RI TË LV-së | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania: Ruisë i janë vrarë dhe plagosur 50 000 ushtarë në Ukrainë

LONDËR, 17 KORRIK - Rusia ka humbur rreth 50 000 ushtarë të cilët i janë vrarë ose plagosur gjatë pushtimit të Ukrainës dhe rreth 1 700 tanke i janë shkatërruar, tha kreu i forcave të armatosura të Britanisë. Por, admirali Tony Radakin, i tha BBC-së më 17 korrik se çdo spekulim se humbjet mund të rrezojnë qeverinë e presidentit rus, Vladimir Putin, janë thjesht “dëshirë”. “Mendoj se disa nga komentet se ai nuk është mirë ose dikush me të vërtetë do ta vrasë atë ose do ta largojë nga

pushteti janë thjesht dëshirë”, tha ai duke iu referuar Putinit. “Si profesionistë ushtarakë, ne shohim një regjim relativisht të qëndrueshëm në Rusi. Presidenti Putin ka qenë në gjendje të shuajë çdo opozitë. Ne shohim një hierarki që është e investuar te presidenti Putin dhe kështu që askush që është në krye nuk ka motivim për ta sfiduar presidentin Putin”, shtoi Radakin. Shefi i ushtrisë britanike tha se me ngecjet në Ukrainë forcat tokësore të Ruisë tani paraqesin më pak kërcënim

sesa që paraqitnin para se të niste lufta.

Përveç humbjeve në personel dhe tanke, Ruisë i janë shkatërruar rreth 4 000 mjete të blinduara luftarake që prej pushtimit të 24 shkurtit, tha shefi i ushtrisë britanike. “Por, Rusia vazhdon të jetë një fuqi bërthamore. Ka aftësi kibernetike, ka aftësi hapësinore dhe veçanërisht ka programe nën ujë ose mund të kërcënojnë që t’i sulmojnë kabllot që gjenden nën ujë që lejojnë që informacioni të qarkullojë në mbarë botën”.



Shkupi dhe Sofja nënshkruajnë protokollin për kapërcimin e dallimeve

SHKUP, 17 KORRIK - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë Veriut dhe ai i Bullgarisë, Bujar Osmani dhe Teodora Gençovska, nënshkruan të dielën në Sofje protokollin që parashihet procedurat dhe dinamikën e kapërcimit të dallimeve mes tyre, që janë pjesë e propozimit francez. Përmbajtja e protokollit nuk është publikuar.

Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha se kanë pasur bisedë konstruktive dhe thelbësore për punën e pesë grupeve dhe, sipas tij, në protokoll shihet se është bërë shumë dhe secili që është përfshirë ka investuar sa më shumë që të ketë projekte, memorandume dhe dokumente që forcojnë



marrëdhëniet mes dy vendeve. Sipas Osmanit, duhet hapur një kapitull i ri me qëllim që bashkëpunimi të jetë më i ngushtë dhe i bazuar në besim. “Për ne është një mundësi historike që pas 17 vjetësh status kandidat, Maqedonia e Veriut merr mundësinë që nesër,

pasnesër, t’i fillojë negociatat me BE-në, që fillon fazën e fundit të anëtarësimit tonë në BE. Shpresojmë që ky proces dypalësh bashkëpunimi me Republikën e Bullgarisë, por edhe rruga tjetër e negociatave të anëtarësimit me BE-në, do të mundësojë bashkëpunim më të ngushtë

mes dy vendeve. Presim mbështetje nga Republika e Bullgarisë në këtë rrugë, e cila sapo ka filluar negociatat për anëtarësim në BE”, tha Osmani.

Ministrja e Jashtme e Bullgarisë, Teodora Gençovska, tha se takimi ka qenë i dobishëm dhe është shënuar përparim në të gjithë sektorët. Sipas saj, “tani mbetet të përmbushet ajo që është rënë dakord, që kërkon angazhim serioz nga të dyja vendet”.

Gençovska tha se Bullgaria është vendi që mbështet fuqishëm integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

Me nënshkrimin e protokollit hapet rruga për mbajtjen e konferencës së parë politike ndërqeveritare të Maqedonisë

së Veriut dhe BE-së.

Komisioni i përbashkët ndërqeveritar është pjesë e detyrimeve që dalin nga Traktati i Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit të nënshkruar mes dy vendeve në vitin 2017.

Nënshkrimi i protokollit vjen një ditë pasi Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miratoi propozimin francez, që i hap rrugë integritit të Shkupit në BE. Pas miratimit, zyrtarët e BE-së kanë paralajmëruar se negociatat për anëtarësim në bllok për Shkupin dhe Tiranën do të hapen javën e ardhshme. Për gati dy vjet, Bullgaria, shtet anëtar i BE-së, mbajti në fuqi veton për nisjen e negociatave mes bllokut dhe Shkupit, për shkak të mospajtimeve sa i përket historisë dhe gjuhës maqedonase.

Evropa vazhdon të përballet me zjarre

LISBON, 17 KORRIK - Mijëra zjarrfikës po vazhdojnë të përballen me zjarre në Portugali, Spanjë dhe Francë, teksa vala e të nxehtit nuk po jep shenja lehtësimi.

Në veri të Portugalisë një pilot vdiq pasi avioni me të cilin po hidhte ujë u përplas në zonën Foz Coa, afër kufirit me Spanjën.

Autoritetet portugeze thanë se të paktën 238 persona kanë vdekur nga i nxehti në javën e fundit.

Zjarre janë përhapur edhe në jugperëndim të Francës, në rajonin Gironde, ku 12 000 persona janë evakuuar.

Valët e të nxehtit janë bërë

më të shpeshta, më intensive dhe po zgjasin më shumë për shkak të ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga njerëzit. Bota tashmë është ngrohur për rreth një gradë celsius që nga fillimi i epokës industriale dhe temperaturat do të vazhdojnë të rriten nëse qeveritë në mbarë botën nuk bëjnë shkurtime të mëdha në emetimet e karbonit.

Meteorologët në Francë po parashikojnë se temperaturat do të arrijnë deri në 41 gradë në jug të Francës të dielën, teksa rekordi i temperaturave të larta pritet të shënohet të hënën.

Autoritetet në Francë thanë



se si pasojë e zjarreve deri më hektarë tokë.

tani janë djegur 10 000 Që prej të martës, në

Portugali temperaturat kanë arritur deri në 47 gradë celsius dhe në Spanjë mbi 40 gradë, por autoritetet kanë thënë se nga java e ardhshme temperaturat pritet të bien.

Edhe pjesë të tjera të Mesdheut po përballen me zjarre. Në Itali qeveria ka shpallur gjendje emergjente për shkak të temperaturave të larta. Në Greqi zjarrfikësit po përballen me zjarret në zonën Feriza, rreth 50 kilometra në juglindje të Athinës, por edhe në Rethymo, që gjendet pranë Kretës. Maroku, po ashtu, po përballen me zjarre ku, për pasojë, një person ka vdekur.

Lëndohen pesë zyrtarë policorë gjatë një aksioni kundër kontrabandës me mallra në veri



Sveçla kritikon organet e drejtësisë që liruan të dyshuarin e dytë

Por, me lirim në procedurë të rregullt të të dyshuarit të dytë nuk është pajtuar ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla. “Zyrtarët policorë i kanë kërkuar Prokurorisë Speciale ta marrë ngjarjen në hetim. Edhe pas këmbënguljes së tyre, Prokuroria nuk u përgjigj pozitivisht. Ndërkohë, prokurorja e Prokurorisë Themelore e liroi menjëherë njërin prej kontrabandistëve sulmues të policisë”, tha Sveçla në “Facebook”. Sipas tij, “hezitimi për të vepruar i organeve të drejtësisë, përkthehet automatikisht në fuqizim të kriminelëve dhe rritje të vetëbesimit të ta”. Minsitri Sveçla tha se në aksionin e 16 korrikut është dashur të ndërhyjnë edhe pjesëtarët e njëjve speciale të Policisë së Kosovës për t’i kapur të dyshuarit.

Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një konference për medie në selinë e partisë së tij, Lëvizjes Vetëvendosje, falënderoi Policinë e Kosovës për trimërinë dhe profesionalizmin në luftën kundër krimit dhe kontrabandës, por kërkoi që edhe hallkat e tjera të sistemit ta kryejnë punën e tyre. “Por, në të njëjtën kohë shpresoj e uroj që edhe hallkat e tjera të sistemit të drejtësisë, prokuroria e gjyqësori, të jenë në nivel të detyrës në mënyrë që të mos na përsëriten rastet e tilla”, tha Kurti.

Edhe në të kaluarën zyrtarët policorë të Kosovës janë penguar gjatë aksioneve të tyre kundër kontrabandës, ndërkaq në fillim të këtij viti janë regjistruar edhe sulme ndaj policisë edhe me mjete shpërthyes.

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 KORRIK - Policia e Kosovës ka njoftuar të dielën se pesë zyrtarë të saj janë lënduar gjatë një aksioni për të ndaluar një kamion në veri të Kosovës që dyshohej se po kontrabandonte mallra. Policët kanë marrë trajtim mjekësor, ndërsa është dëmtuar një veturë policore. Sipas njoftimit, në orët e mbrëmjes të 16 korrikut në fshatin Jashanicë të Leposaviqit zyrtarët policorë kanë vërejtur kamionin që dyshohej se po kontrabandonte mallra, por

në tentim për ta ndaluar, policia është penguar nga dy automjete civile.

Policia thotë se më pas ka bërë bllokimin e pjesëshëm të magjistrales Mitrovicë - Jarinjë me dy automjete policore. “Policia e Kosovës në fillim ka ndaluar një veturë me ngjyre të zezë, targa të panjohura dhe shoferi i saj dyshohet që ishte duke komunikuar në telefon me vozitësin e kamionit. Kamioni i dyshuar me një shpejtësi të madhe ka ardhur në drejtim të veturave dhe zyrtarëve policorë, me qëllim goditjen e tyre dhe me këtë

rast, kamioni ka goditur një veturë zyrtare policore. Përkundër të gjitha sinjalizimeve për t’u ndaluar, duke përfshirë edhe bateritë ndriçuese, i njëjti nuk ka zbatuar urdhrin ligjor të zyrtarëve policorë dhe ka vazhduar vozitjen”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Zyrtarët policorë më pas kanë vazhduar ta përcjellin kamionin, i cili vazhdoi të udhëtonte me shpejtësi të lartë në magjistralen Mitrovicë - Jarinjë. “Në përpjekje e sipër për ta ndaluar, vozitësi i kamionit e

ka goditur veturën policore për herë të dytë, duke u shkaktuar lëndime zyrtarëve policorë si dhe duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale”, thuhet në njoftim. Policia thotë se arriti që ta ndalë kamionin në fshatin Llazhinë dhe ka arrestuar vozitësin A. D. (1990). Shoferi është dërguar në mbajtje dhe dyshohet për veprat “kalim i kufirit ilegal”, “kontrabandim me mallra” dhe “sulm ndaj personit zyrtar”. Ndërkaq, U. R, që ngiste veturën që ndihmoi shoferin e kamionit, është liruar në procedurë të rregullt.

Kosova regjistron një viktimë dhe mbi 800 raste të reja me koronavirus

PRISHTINË, 17 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë bëri me dije se është regjistruar një viktimë dhe 852 raste të reja me koronavirus. Rastet e reja dolën pas testimit të 2 201 mostrave, apo 38.7 për qind e mostrave dolën pozitive me sëmundjen Covid-19.

Në 24 orët paraqite janë shëruar 394 persona, bëri me dije MSh-ja.

Raste aktive me koronavirus në Kosovë janë 5 359.

Kosova së fundmi po regjistron rritje të rasteve me Covid-19, gjë që i ka shtyrë autoritetet t’i shpeshtojë thirrjet që qytetarët të vaksinohen dhe të bartin maskë në ambiente të mbyllura. Isme Humolli, zyrtare

profesionale e emergjencave në Organizatën Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, thotë se rritja e rasteve me koronavirus që vendi po përjeton së fundmi ka qenë diçka e pritshme për shkak të grumbullimeve në masë.

Ajo thotë se OBSH-ja aktualisht nuk e sheh si opsion kthimin e maskave dhe kufizimet e lëvizjes, por shton se qytetarët duhet t’i shmangin aktivitetet ku ka grumbullim të njerëzve sikurse dasmat.

Në këtë intervistë ajo flet edhe për procesin e vaksinimit të qytetarëve të Kosovës kundër koronavirusit dhe tregon nëse

shteti ka arritur synimet e vendosura për vaksinim. “Ajo që është duke ndodhur në Kosovë është diçka e pritshme, duke pasur parasysh faktin që numri i rasteve me Covid-19 rritet kur shtohen aktivitetet e grumbullimit në masë. Jemi dëshmitarë të asaj se në momentin kur kanë filluar të organizohen ngjarje të ndryshme, atëherë edhe ka filluar rritja e numrit të rasteve. Ajo çka preferohet nga OBSH-ja është që t’i iket grumbullimit të njerëzve, sidomos atyre që mund t’u iket, siç janë organizimet për ribashkime të mbrëmjeve të maturave, mundësisht edhe dasmave me



një numër sa më të ulët të rasteve. Kthimi i maskave dhe kufizimet e lëvizjes për momentin nuk janë opsion, si

alternativë as nga OBSH-ja, as nga shtetet e ndryshme. Por, jemi duke e vëzhguar situatën”, ka thënë Humolli.



PARTITË OPOZITARE VAZHDOJNË TA KRITIKOJNË QEVERINË KURTI NË RAPORT ME GJENDJEN NË VEND

Opozita: Kosova është në krizë shumë të thellë

Përfaqësuesit e partive politike, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë theksuar se Kosova është në ditët më të vështira të stresit social dhe ekonomik që nga paslufta. Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Besnik Tahiri kanë thënë se kryeministri Kurti nuk njuh rritjen e çmimeve e vështirësitë e familjeve në vend. Sipas tyre, Kosova është në krizë shumë më të thellë se çdo shtet evropian, pasi nuk kemi qeveri që u del në krah qytetarëve të saj

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, e ka kritikuar kryeministrin Kurti se po ik nga përgjegjësia qeverisëse në krizën më të madhe ekonomike të vendit që nga paslufta. I pari i PDK-së ka thënë se për një kryeministër të përgjegjshëm e veçmas në këto rrethana krize nuk do të duhej të kishte shumë vend për konferenca shtypi nga selia e partisë, sepse detyra e parë e tij

është mandati përballë qytetarëve e jo defilimi përballë militantëve. "Por, ai që refuzon të përgjigjet e të mbajë përgjegjësi për dështimet përballë qytetarëve, gjithmonë do ta kërkojë shpëtimin diku tjetër", ka thënë Krasniqi. Sipas kryetarit të PDK-së, Kosova është në ditët më të vështira të stresit social dhe ekonomik që nga paslufta. "E duke qenë i paaftë për përgjegjësitë e një kryeministri, Albin Kurti po kërkon t'i ikë ballafaqimit me gjendjen, duke e shitur si 'ngjarje' për popullin,

mbajtjen e një procesi të rëndomtë zgjedhor të subjektit të tij politik. Mbajtja e zgjedhjeve brenda Lëvizjes Vetëvendosje është pjesë e demokracisë, por 'ngjarja e vërtetë' është kriza që ka përfshirë gjithsecilën familje në vend", ka thënë Memli Krasniqi. Më tej, lideri i PDK-së ka theksuar se komoditeti për t'u angazhuar në rrethanat aktuale të krizës së përgjithshme ekonomike i shkon për shtati pikërisht një kryeministri të këtyllë, i cili merret me zgjedhje

në parti, sepse s'ka kurrfarë zgjidhje për popullin. "Fatkeqësisht, ai jo vetëm që s'ka zgjidhje për krizën, por nga paaftësia e tij qeverisëse është duke i kontribuar edhe më shumë asaj. Në këto rrethana qytetarëve u duhet një kryeministër që mendon për zgjidhje të problemeve e jo për zgjedhje partiake. Prandaj, kryeministri duhet ta rikthejë fokusin e të përqendrohet për të marrë masa të qëndrueshme për t'ua lehtësuar qytetarëve të vendit tanë ballafaqimin me këtë krizë ekonomike gjithëpërfshirëse e të kudondodhshme", ka theksuar Krasniqi. Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se popullisti Albin Kurti nuk e njuh më realitetin. "I dehur nga jeta prej pushtetari, ai i ka krijuar vetes një Kosovë paralele ku gjërat s'mund të jenë keq kur ai vetë

është mirë. Prandaj ai sot nuk njuh rritjen e çmimeve e vështirësitë e familjeve kosovare. Kosova është në krizë shumë më të thellë se çdo shtet evropian - e ne nuk kemi qeveri që u del në krah qytetarëve të saj. As atëherë kur inflacioni arrin frikshëm në 14.1 % e as atëherë kur propozimet e zgjidhjet i ka që nga marsi i këtij viti në tavolinë", ka deklaruar Abdixhiku. Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie, ka theksuar se Kosova po udhëhiqet nga një qeveri që nuk ka guxim të marrë vendime, me këtë qasje në muajt në vazhdim kriza do të thellohet. "AAK-ja është e preokupuar me mosveprimet e Qeverisë së Kosovës për t'i adresuar problemet me të cilat ballafaqohet Kosova dhe qytetarët e saj. Kemi kërkuar një interpelancë për ministrin e

Më 15 gusht nis gara për kryetarin e ri të LV-së



PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh edhe kryeministër i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie ka folur për procesin e brendshëm zgjedhor në subjektin që ai drejton. Ai ka thënë se qendrat e LV-së deri më tani kanë organizuar zgjedhje në 300 pika. "Risi kësaj here është se në LV do të ketë dy struktura të reja organizative: atë të gruas dhe rinisë. 14 mijë e 641 gra e vajza në LV do ta kenë organizatën e

tyre, sikurse 17 mijë e 331 të rinj e të reja do ta kenë organizimin e tyre brenda subjektit tonë", ka thënë Kurti. Kurti ka shtuar se ky proces e gjen LV-në në një nivel tjetër, derisa shtoi se zgjedhje brenda LV-së nuk do të ketë deri në vitin 2026. "Për katër vitet e ardhshme nuk do të ketë proces më të rëndësishëm sesa ky. Zgjedhje nuk do të ketë deri në vitin 2026, andaj është e domosdoshme që organizata jonë të përgatitet për këto zgjedhje me pjesëmarrje të të

gjithëve. Nuk do të ketë as zgjedhje lokale as nacionale, pas këtyre zgjedhjeve të brendshme të LV-së që janë të fundit para zgjedhjeve të ardhshme", ka thënë Kurti. Ai nuk e ka bërë me dije nëse do të jetë sërish kandidat për kryetar të LV-së. Kurti ka thënë se fjalën e tij do ta thotë pas katër javëve, kur edhe do të hapet afati për shpalljen e kandidaturave për kryetar të LV-së. Sekretarja organizative e LV-së, Vlora Haxhimehmedi, u

shpreh se që nga 15 marsi kur janë shpallur zgjedhjet e brendshme, LV-së i janë shtuar 2 446 anëtarë të rinj, ku numri i përgjithshëm i anëtarëve ka shkuar në 59 291. E koordinatori për qendra, Valon Hoti, ka thënë se më 15 gusht do të shpallen zgjedhjet për kryetar të LV-së, kryetar të organizatës së gruas dhe rinisë për LV-në. "Njëjtë edhe për nivelin e dytë organizativ ku me të njëjtën datë do të shpallen zgjedhjet për kryetar për të gjitha qendrat e LV-së.

Afati do të jetë i hapur deri më 23 gusht ku secili anëtar i LV-së ka të drejtë të garojë", ka thënë Hoti. Ai shtoi se më 1 shtator zyrtarisht hapet fushata për kandidatët për kryetar të LV-së. "23 shtatori do të jetë dita kur do të mbyllet fushata, dhe më 25 shtator e gjithë anëtarësia voton për kryetarin e ri të LV-së dhe të gjitha pozicionet drejtuese", ka thënë Hoti, derisa ka shtuar se më 27 shtator shpallen fituesit e zgjedhjeve.

Financave, Hekuran Murati, për Ligjin e Pagave për sektorin publik. Në mungesë të këtij ligji, i cili zvarritet tash e një vit e gjysmë, 80 mijë zyrtarë publikë janë peng i një qeverie, e cila nuk merr asnjë veprim", ka deklaruar Tahiri. Ai ka thënë se interpelanca e dytë ka të bëjë me administratën shtetërore, pra me zyrtarët publikë. "Sa i përket Ligjit për Zyrtarët Publikë, sipas aktvendimit të publikuar në korrik të vitit 2020, është dashur

që ky ligj të amandamentohet. Pra, në mungesë të amendamentimit të këtij ligji, që është detyrim kushtetues, shumë organizata buxhetore kanë filluar të bëjnë rregulloret e tyre të brendshme kundërligjshëm", është shprehur Tahiri. Në raport me pagën minimale, ai ka treguar se kanë adresuar amendamentin, ku kanë kërkuar që paga minimale të jetë 350 euro neto. "Interpelanca e tretë ka të bëjë

me problemin e energjisë elektrike. U kemi dërguar letra të gjitha institucioneve relevante që trajtojnë çështjen e energjisë elektrike: KEK-ut, ZRRë-së, KEDS-it, KESCO-së, KOST-it për një takim që të informohemi dhe si kuvend t'i marrim përgjegjësitë tona. Sipas informacioneve që kemi si subjekt politik, energjia elektrike do të jetë problemi kryesor në muajt në vijim. Preokupimi kryesor për AAK-në është kolapsi ekonomik në

vend, me një qeveri e cila vazhdon të jetë një kor i recitaleve me kryerecitalistin, Albin Kurti, i cili duhet t'i ndalë recitalet dhe të marrë vendime dhe veprime", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se kanë kërkuar heqjen e akcizës së naftës për një periudhë të caktuar dhe uljen e tatimit në produkte bazike. "Shqetësim mbetet rreziku i dështimit të projekteve të investimeve publike për shkak të rritjes së përgjithshme të kostos. AAK-ja propozon

subvencionimin e këtyre kontratave në mënyrë që projektet kapitale mos të dështojnë. Kosova nuk po zbrazet për shkak të luftës, as për shkak të persekutimit politik, por për shkak të mosveprimeve të qeverisë inekzistente, e cila vazhdon recitalet e rimat për të treguar sa e zonja është në aspektin akademik, por sa e dobët në vendimmarrje dhe sa e pazotë t'u dalë ballë problemeve që i ka Kosova", ka deklaruar Tahiri.

Zbulohen pllakat në shtëpitë që kanë qenë baza dhe në shërbim të UÇK-së

RAHOVEC, 17 KORRIK (ER) - Të dielën, në praninë e bashkëlufetarëve, familjarëve të dëshmorëve dhe qytetarëve, në kujtim të Epopesë së Rahovecit, janë zbuluar pllakat në shtëpitë që kanë qenë baza dhe në shërbim të UÇK-së. “Ndër

shumë të tilla ishin edhe shtëpia e familjes së Xhemajli Jahës dhe familjes së Hidajet Haxhijahës nga Rahoveci. Baza të forta në përkrahje të luftës ishin edhe shtëpitë e Adem Amrush Krasniqit dhe Muharrem Ibrahim Krasniqit nga

Senoci”, ka thënë kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, duke shtuar se do të vazhdojnë t’i identifikojnë dhe t’i regjistrojnë në hartën e rezistencës dhe luftës për liri, të gjitha ato shtëpi që kanë qenë në shërbim të luftës sonë çlirimtare.



Arsim Bajrami viziton krerët e UÇK-së në Hagë: Një betejë e fortë ligjore po na pret

HAGË, 17 KORRIK (ER) - Ish-ministri i Arsimi, Arsim Bajrami, ka vizituar në Hagë liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimim dhe të tjerët, të cilët po akuzohen për krime luftime.

Bajrami ka thënë se ata janë duke u mbajtur padrejtësisht në paraburgim, duke theksuar se lufta e UÇK-së ka qenë mbrojtëse dhe çlirimtare. “Një betejë e fortë ligjore po na pret, për ta dëshmuar pafajësinë e të arrestuarve dhe për ta rrezuar

kualifikimin e pasaktë për ‘ndërmarrjen e përbashkët kriminale’. Gjenocidi i Serbisë në Kosovë ka qenë ndërmarrje e organizuar shtetërore, kurse lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë mbrojtëse dhe çlirimtare”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”.

Ndalohet hyrja e studentëve serbë në Prekaz

SKENDERAJ, 17 KORRIK (ER) - Studentët e huaj dhe ata vendorë që po ndjekin studimet në Universitetin Veror të Prishtinës kanë paralajmëruar se do ta vizitojnë Prekazin. Pjesë e këtij grupi ishte raportuar se do të jenë edhe disa studentë serbë.

Ndaj këtyre raportimeve kanë reaguar qytetarë nga qyteti i Skenderajt, duke thënë se ata nuk do ta lejojnë që një vizitë e tillë të ndodhë.

Tifozët e Klubit të Drenicës “Shqiponjat e Zeza” kanë njoftuar se pas iniciativës së tyre dhe të disa pjesëtarëve të organizatës së veteranëve, gjatë ditës së dielë ata kanë penguar hyrjen e studentëve serbë në Prekaz. “Shqiponjat e Zeza, të

përkrahura nga qytetarë dhe pjesëtarë të organizatës së veteranëve, u mblodhën sot për ta bllokuar hyrjen që çon drejt Memorialit të Prekazit. Edhe pas informacionit nga Policia e Kosovës (atyre që ishin të pranishëm në turmë), se vizita e studentëve që kishte edhe studentë serbë është anuluar për shkak të reagimit tonë publik, “Shqiponjat e Zeza” do të jenë të pranishme gjatë tërë ditës në vëzhgim të qytetit dhe Prekazit në mënyrë që nëse informacioni nuk është i saktë, ta pengojnë hyrjen e tyre. Çdo moment e më shumë po na bashkohen njerëz”, thuhet në reagimin e tyre në “Facebook”. Për këtë gjë tifo grupi “Shqiponjat e Zeza” thanë se

këmba e këtyre studentëve nuk do të shkelë në Prekaz për shkak të të gjithë atyre pleqve, grave, fëmijëve e burrave të cilët u vranë dhe u masakruan të pafajshëm nga forcat serbe. “Ndiejmë obligim t’i informojmë studentët në fjalë që edhe pse në numër do të jenë pakicë, këmba e tyre nuk shkel nesër në Prekaz. Nuk duam t’ia dimë sa kohë ka kaluar, nuk duam t’ia dimë as për gjeneratat e reja “kurioze” të tyre, sepse po të ishin aq kuriozë për Prekazin do ta mjaftonte t’i pyesnin familjarët e tyre se si në ato varre prehen shumë pleq, gra, fëmijë e burra të gjakut tonë të cilët u vranë e u masakruan të pafajshëm”, kanë shkruar ata në “Facebook”.



Mbi dy mijë persona kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës brenda gjashtë muajve

PRISHTINË, 17 KORRIK - Krahas trendit të emigrimit nga Kosova për në vendet e Bashkimit Evropian, numër i madh i qytetarëve po heqin dorë edhe nga shtetësia.

Vetëm në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti, janar-qershor 2022, nga shtetësia e Republikës së Kosovës kanë hequr dorë 2 210 persona, ka bërë me dije Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, në një përgjigje me shkrim për “Telegrafin”. “Në periudhën janar-qershor 2022 janë liruar nga Shtetësia e Republikës së Kosovës 2210 persona”, ka deklaruar Ministria e Punëve të



Brendshme.

Më tej nga Ministria e Punëve të Brendshme thuhet se arsyeja pse

qytetarët po heqin dorën nga shtetësia e Kosovës është se shumë vende të Bashkimit

Evropian ku jetojnë ata nuk i lejojnë që t’i kenë dy shtetësi. “Arsyet pse personat heqin dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës është pasi që shumë shtete të Bashkimit Evropian nuk lejojnë dyshtetësinë, përfshirë këtu edhe disa shtete që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian”, thuhet në përgjigjen MPB-së. Sipas kësaj ministrie, ata janë të obliguar të lirohen nga shtetësitë e mëparshme nëse dëshirojnë ta fitojnë shtetësinë e vendit përkatës. “Duke pasur parasysh që një numër i madh i shtetasve tanë jetojnë tashmë me vite në këto shtete, e një numër i madh edhe kanë lindur në këto shtete

dhe si rezultat i saj kanë fituar të drejtën e fitimit të shtetësisë dhe janë të obliguar të lirohen nga shtetësia e mëparshme në rast se dëshirojnë ta fitojnë shtetësinë e atij vendi. Pra, arsyeja kryesore është ndalimi i dyshtetësisë në shumë vende”.

Sipas të dhënave, mesatarisht në vit nga shtetësia e Kosovës janë liruar më shumë se 5 000 qytetarë. Trendi i lirimimit nga shtetësia ka shënuar ngritje nga viti 2014.

Vendet ku qytetarët e Kosovës kanë emigruar më së shumti gjatë viteve 2010 - 2018 janë Gjermania, Franca, Austria, Kroacia e shtete të tjera.

E vërteta mbi zbulimin e naftës dhe gazit në Shqipëri



TIRANË, 17 KORRIK - Deklarata e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, se ky vend gjendet pranë një zbulimi të madh të një vendburimi naftë që, sipas tij, do të ndryshojë të ardhmen e Shqipërisë dhe, në një shkallë më të vogël, të vet Evropës, nuk është e para e tillë.

Deklarata të ngjashme ai ka bërë edhe më herët, ashtu si edhe politikanë të tjerë të Shqipërisë. “Shenjat tregojnë se mund të jemi pranë një zbulimi shumë, shumë të rëndësishëm në tokë, të gazit dhe naftës, që jo vetëm se do të ndikojë jashtë mase në të ardhmen e vendit tonë, por do të luajë një rol edhe në të ardhmen energjetike të Evropës”, ka thënë Rama më 5 korrik.

Lajmi i tij është konfirmuar më pas edhe nga ministrja e Infrastruktursë dhe Energjisë e Shqipërisë, Belinda Balluku, e cila më 6 korrik ka thënë: “Kompania ‘Shell’ po punon tashmë prej disa kohësh në Shqipëri dhe ne po presim me padurim rezultatin e eksplorimit, që do të jetë një zbulim i madh”.

Si kryeministri Rama, ashtu edhe ministrja Balluku, kanë thënë se kompania ndërkombëtare “Shell” nuk jep të dhëna dhe shifra konkrete por, sipas tyre, ajo ka deklaruar se “Shqipëria do të jetë një vend që do të prodhojë një sasi të rëndësishme naftë dhe gazit - e ndarë 60 % për naftën dhe 40 % për

gazin”.

Zbulimi, me sa duket, i referohet fushës naftëmbajtëse të Shpiragut, që ndodhet në jug të Shqipërisë, rreth malit gëlqeror të Shpiragut.

Fusha është eksploruar për herë të parë në vitin 2001 nga kompania “Occidental Petroleum”, e cila më pas ka vendosur të mos e zhvillojë projektin e saj për shfrytëzim, pasi e ka gjykuar jo të leverdishëm.

Që nga ajo kohë kompania “Shell” dhe investitorë të tjerë kanë shpenzuar dhjetëra miliona euro për shpimin e katër puseve provë, që shkojnë në më shumë se 6 000 metra thellësi, me shpresën për rezultate.

Më 23 janar të vitit 2019 kryeministri Rama dha një lajm “inkurajues” për zbulimin e rezervave të naftës në Shqipëri. “Edhe pak javë na ndajnë nga prova e së vërtetës së Shpiragut, ku të gjitha të dhënat flasin për një rezervë të madhe gazi e naftë”, ka shkruar Rama në “Twitter”.

Katër muaj më pas, më 24 maj 2019, kreu i ekzekutivit të Shqipërisë ka shkruar sërish se gjatë takimit me përfaqësues të kompanisë “Shell”, të dhënat flasin për një rezervë të madhe gazi dhe naftë në Shpirag.

Kujtojmë se “Manas Petroleum”, një kompani tjetër, ka shpuar në të njëjtën zonë një pus prove, të njohur si ‘Shpirag 2’ në vitin 2012.

Aksionet e kësaj kompanie më pas janë blerë nga kompania “Shell”, e cila ka marrë përsipër shpimet në vitin 2016, me puset provë: Shpirag 3 dhe 4.

Atëbotë, përkatësisht më 6 nëntor të vitit 2013, ish-kryeministri Sali Berisha komentonte zbulimin e naftës në pusin e Shpiragut si një zhvillim tejet të rëndësishëm për vendin, teksa deklaronte se “pas tre vjetësh studimi, u konfirmua gjetja e një burimi të rëndësishëm të ri naftë, të cilësisë së lartë, me një kapacitet fillestar prej 1 300 fuçish në 24 orë”.

I pyetur nga “Radio Evropa e Lirë”, eksperti i energjisë dhe ish-zëvendësministri i Energjetikës i Shqipërisë, Pajtim Bello, thotë se zona që i referohet kryeministri Rama është një zonë perspektive e studiuar dhe e deklaruar si e tillë tash e sa dekada. “Në këndvështrimin historik, Zona e Shpiragut ka qenë konsideruar me perspektivë naftë dhe gazmbajtëse. Në vitet 1975-1990 janë kryer punime gjeologjike dhe sizmike. Bazuar në këto punime, është kryer një pus prove dhe u përforcua bindja gjeologjike për ekzistencën e një strukture naftë dhe gazmbajtëseje. Por, vetëm deri këtu, sepse pas vitit 1990 u ndërpreu punimet”, thotë Bello.

Bazuar në këto punime, shton ai, kjo zonë iu kërkua qeverisë shqiptare

nga ana e kompanisë “Shell” dhe mes tyre u lidh një marrëveshje në vitin 2012. “Në vitin 2014, ‘Shell’, pas disa punimeve gjeologjike-sizmike, kreu një test prove dhe u bë publike se është mundësia e konkretizimit të një vendburimi naftë e gazi. Por, nuk janë dhënë shifra dhe detaje. Natyrisht, kryeministri Rama ka të dhëna të rezervuara dhe ne që kemi njohuri mbi zonën, kemi shprehur për një vendburim të konsiderueshëm. Pa e mohuar meritën e madhe të ‘Shell’-it, unë deklaroj se meritë kanë gjeologët dhe sizmologët shqiptarë, të cilët punuan para viteve 1990 dhe konturuan idenë e një perspektive të qartë”, thotë Bello për “Radion Evropa e Lirë”.

Nafta është zbuluar për herë të parë në Shqipëri pothuajse një shekull më parë, në zonën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës, që gjendet në juglindje të Shqipërisë, përkatësisht në komunën e Fierit.

Pas rënies së komunizmit në vitin 1991, disa kompani të huaja shpenzuan shuma të mëdha parash për të kërkuar naftë në tokën dhe detet në Shqipëri, por pa shumë rezultat.

Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, eksperti i energjetikës dhe bashkautor i studimeve mbi burimet hidrokarbure në Shqipëri, Stavri Dhima, thotë se zona e Shpiragut, prej kohësh, ka qenë

vend i studimeve për kërkimzbulimin e naftës e gazit. Sipas tij, duhet pasur në konsideratë jo vetëm studimet që janë kryer deri në vitet ‘90 nga ana e institucioneve dhe kompanive shqiptare por, po ashtu, edhe studimet e kryera gjatë periudhës 1998 deri 2005, përpara angazhimit të kompanive të huaja, si “Petromanas” dhe “Shell”, dhe më vonë. “Ishte pikërisht marrëveshja e re hidrokarbure që u lidh në vitin 2009 me kompaninë zvicerane DWM Petroleum AG që rifilloi punimet e kërkimit në këtë rajon, punime që u konkretizuan me rezultat mjaft pozitiv të pusit Shpiragu-2 nga kompanitë ‘Petromanas’ dhe ‘Shell’, dhe të cilat vazhdojnë edhe sot nga kompania ‘Shell’ për konkretizimin e vendburimit të naftës dhe gazit të Shpiragut, për të cilin kemi besim të plotë se do të konkretizohet deri në fillimin e vitit tjetër, duke kaluar në fazën e shfrytëzimit”, thotë Dhima. Megjithatë, ndikimi që do të ketë një zbulim i tillë në buxhetin e shtetit do të varet nga kostoja e prodhimit të naftës, ndërsa kjo e fundit, në një masë jo të vogël, pritet të varet nga aftësia e menaxhimit të autoriteteve publike në Shqipëri. Përfitimet që Shqipëria ka nga nxjerrja e naftës në Patos-Marinzë arrijnë në afërsisht 15 % mbi vlerën totale të naftës së nxjerrë.

Kush janë aleatët e Amerikës në Ballkan



Nga Hamza KARCIC
“Newsweek”

Shtetet e Bashkuara janë një partner i besueshëm, dhe imazhi i tyre ndërkombëtar është kryesisht pozitiv. Ky ishte në mënyrë të përmbledhur rezultati i sondazhit më të fundit të Qendrës Kërkimore Pew të publikuar më 22 qershor. Ndërkohë, një sondazh tjetër i kryer në Ballkan tregoi se Amerika shihet shumë pozitivisht në këtë rajon, me Bosnjën dhe Kosovën që mbeten si vendet më pro-perëndimore. Që të dyja sondazhet tregojnë se imazhi global i Amerikës po përmirësohet.

Sondazhi i Qendrës Pew, i kryer në 17 vende, parashikon kohëra të mira për SHBA-në dhe Perëndimin. Amerika shihet në mënyrë të favorshme nga 61 për qind e të anketuarve nga shkurti deri në maj të këtij viti. Presidenti Joe Biden shihet pozitivisht nga 60 për qind e të anketuarve.

Pas pushtimit rus të Ukrainës, pikëpamja ndaj NATO-s është pozitive dhe në rritje, me një favorizim të përgjithshëm prej 66 për qind. Në fakt, gjatë 18 muajve të fundit, 2 ngjarje e përmirësuan imazhin ndërkombëtar të Amerikës: fillimi i mandatit të presidentit

Joe Biden në Shtëpinë e Bardhë në janarin e vitit 2021, dhe përgjigja e udhëhequr nga SHBA-ja për ta ndihmuar Ukrainën përballë pushtimit të Rusisë në shkurt të këtij viti.

Menjëherë pas publikimit të gjetjeve të Qendrës Kërkimore Pew, rezultatet e një sondazhi të kryer në rajon nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI), treguan në mënyrë të ngjashme se imazhi i Amerikës është pozitiv në një cep të Evropës: në Ballkan.

I kryer në fillim të këtij viti dhe para pushtimit rus të Ukrainës, rezultatet e sondazhit janë qetësuese. Bosnja, Kosova dhe Maqedonia e Veriut mbeten pro-amerikane dhe pro-perëndimore. Një ndarje etnike tregon se boshnjakët dhe shqiptarët janë aleatët kryesorë të Amerikës në këtë rajon.

80 për qind e boshnjakëve të anketuar në Bosnje, kishin një opinion pozitiv për SHBA-në, krahasuar me 36 për qind të serbëve dhe 59 për qind të kroatëve. Ndërkohë, 89 për qind e serbëve të Bosnjës kishin një opinion të favorshëm për Rusinë.

Në Maqedoninë e Veriut, 80 për qind e shqiptarëve kishin një pikëpamje të favorshme për SHBA-në. Në Kosovë, rezultatet janë edhe më të habitshme: 94 për qind e shqiptarëve të Kosovës kishin një pikëpamje të

favorshme për SHBA-në. Presidenti Joe Biden mbetet një figurë popullore në Ballkan.

Si senator në vitet 1990, ai ishte një mbështetës i fortë i Bosnjës dhe Kosovës, dhe mbështeti në çdo rast angazhimin e fuqishëm të SHBA-së në Ballkan. Retorika e tij elokumente kujtohet ende me dashuri. 69 për qind e boshnjakëve kishin një pikëpamje të favorshme për Biden, ndërkohë vetëm 15 për qind e serbëve të Bosnjës kishin të njëjtën pikëpamje.

Përkundrazi, 83 për qind e serbëve të Bosnjës kishin një opinion pozitiv për presidentin rus Vladimir Putin. Në Bosnje, shumica është në favor të një politike të jashtme pro-perëndimore, me 42 për qind mbështetje.

Të pyetur se cila duhet të jetë politika e jashtme e Bosnjës, 58 për qind e boshnjakëve ishin në favor të një politike pro-BE dhe pro-perëndimore, ndërsa kroatët 52 për qind. Në Kosovë, rezultatet ishin edhe më mbështetëse për Perëndimin, me 84 për qind të shqiptarëve që janë në favor të këtij kursi.

Ngjashëm, në Maqedoninë e Veriut, 68 për qind e shqiptarëve janë në favor të një qasje pro-perëndimore. Në Bosnje, mbështetja e përgjithshme për anëtarësimin e plotë në NATO është solide, 51 për qind, me një rritje prej 3 për

qind nga viti 2020. Anëtarësimi i Bosnjës në NATO mbështetet nga boshnjakët (69 për qind) dhe kroatët (77 për qind), ndërsa mbështetet nga vetëm 8 për qind e serbëve të Bosnjës.

Në Kosovë, 82 për qind e shqiptarëve janë pro anëtarësimin të plotë të vendit në NATO, në përputhje me përkushtimin e fortë të këtij shteti ndaj institucioneve perëndimore. Ajo që tregoi sondazhi i IRI-së, është se Bosnja, Kosova dhe Maqedonia e Veriut janë pro-amerikane dhe pro NATO-s.

Kështu ka ndodhur që nga ndërhyrjet e udhëhequra nga SHBA në Ballkan në vitet 1990. Edhe kur anti-amerikanizmi u përhap globalisht pas pushtimit të Irakut nga SHBA, mbështetja për Amerikën ishte përgjithësisht e fortë në Bosnje dhe Kosovë, dhe kjo vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Por puna e Amerikës në Ballkan mbetet e papërfunduar. Gjatë 15 viteve të fundit, SHBA-ja e zhvendosi fokusin e saj diku tjetër, dhe ky boshllëk i pushtetit është ndjerë në rajon, dhe atëherë munduar ta mbushë Rusia dhe Kina. Bashkimi Evropian u përpoq që të shtonte ndikimin e saj, por pa rezultat.


Ballkani mbetet aktualisht në harresë, pasi Bosnja dhe Kosova mbeten jashtë Bashkimit

Evropian dhe NATO-s, dhe pa një lidhje të fortë me institucionet perëndimore. Duke investuar politikisht, ushtarakisht dhe financiarisht në rindërtimin e Bosnjës dhe Kosovës, SHBA-ja nuk duhet të lejojë ndërhyrësit si Rusia dhe Kina që të zhbëjnë arritjet e ndërtimit të paqes prej më shumë se 2 dekadash.

Administrata Biden, duhet të dyfishojë përpjekjet e saj për ta integruar në NATO Bosnjën dhe Kosovën. Me Maqedoninë e Veriut tashmë në NATO, pranimi i këtyre dy vendeve në aleancë do ta ancoronte fort tek Perëndimi këtë rajon të paqëndrueshëm.

Zgjerimi i NATO-s në Ballkan do të siguronte siguri dhe stabilitet për Bosnjën dhe Kosovën. Tani që anëtarësimi në BE, është në thelb jashtë diskutimit për të dyja vendet pas samitit të fundit të Këshillit Evropian, nevoja për t’iu bashkuar NATO-s është edhe më e rëndësishme. Pranimi e dy shteteve ballkanike në aleancë, është një mënyrë shumë efektive për të siguruar që Ballkani të mos mbetet si “fuçia e barutit” në Evropë.

Shënim: Hamza Karcic, profesor i asociuar në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Sarajevës, Bosnje Hercegovinë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82


Gjyqtarët e Kosovës delegohen për ndeshjen e Ligës së Konferencës

PRISHTINË, 17 KORRIK - Gjyqtari ndërkombëtar i Kosovës, Genc Nuza është deleguar nga UEFA për të ndarë drejtësinë në

ndeshjen e rrethit të dytë kualifikues në Ligën e Konferencës, ndërmjet skuadrës sllovaqe, MFK Ruzomberok dhe asaj

letone, Riga FC. Nuzës do t'i asistojnë dyshja Fatlum Berisha e Bujar Selimaj, teksa gjyqtar i katër do të jetë Dardan

Çaka. Kjo ndeshje zhvillohet më 21 korrik në "Stadion MFK Ruzomberok" me fillim në orën 18:30.



Shqipëria e bronzte në FIBA Kampionatin Evropian

PRISHTINË, 17 KORRIK - Shqipëria ka shënuar fitore ndaj Kosovës me rezultat 53:68 (8:23, 15:12, 14:20, 16:13), në ndeshjen për vendin e tretë në FIBA Kampionatin Evropian, Divizioni C për meshkuj U16, që po zhvillohet në Prizren. Kuqezinjtë e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke krijuar epërsi 3:21, ndërsa çerekun e parë e fituan 8:23. Lojë më e barabartë u zhvillua në periudhën e dytë, ku Dardanët për një nuancë ishin më të mirë, për të fituar

këtë pjesë 15:13, ndërsa kombëtarët shkuan në pushim me shifrat 23:35. Edhe në pjesën e dytë, Shqipëria ruajti epërsinë, për të triumfuar 53:68. Te Kosova u dalluan Andi Ahmeti me 21 pikë e 11 kërcime dhe Yll Kastrati me 14 pikë, ndërsa të Shqipëria i jashtëzakonshëm ishte Viktorio Hida me 20 pikë e 21 kërcime, duke u ndihmuar nga Oresti Simo me 15 pikë e shtatë kërcime. Në renditjen përfundimtare, Kosova u rendit e katërta, kurse Shqipëria e treta.



Vashat e 'Hasan Prishtinës' fitojnë medaljen e bronzte në botërorin e hendbollit universitar

PRISHTINË, 17 KORRIK - Tanimë kemi mësuar universitetin i cili ka arritur ta sigurojë medaljen e bronzte në konkurrencën e femrave në Kampionatin Botëror të hendbollit për universitete, "FISU Prishtina 2022". Vajzat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" kanë arritur ta sigurojnë medaljen e bronzte në këtë turne, pasi që kanë mposhtur hendbollistet çeke të "UPOL". Pas plot 60 minutave lojë të zhvilluara në sallën "1 Tetori" vashat "Dardane" kanë shënuar fitore me shifrat 26:24 kundër skuadrës çeke. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 14:10 në favor të



hendbollistëve kosovare, kurse e dyta me shifrat 12:14 në favor të çekeve, por që nuk ishte e mjaftueshme për këto të fundit të sigurojnë fitore. Hendbollistet më të mira të

ndeshjes ishin Elisa Mulaj dhe Adela Protivankova me nga tetë gola të shënuar. Vashat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" e mbyllin këtë turne me tre fitore dhe dy humbje.

Kosova e 15-ta në FIBA Kampionatin Evropian

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kosova është renditur e 15-ta në FIBA Kampionatin Evropian, Divizioni C për femra U20, që po zhvillohet në Maqedoninë Veriore. Në ndeshjen për vendin e 15-të, vashat e Kosovës kanë mundur Armeninë me rezultat 64:70 (16:15, 22:24, 12:14, 14:17) "Dardanet" kishin epërsi të lehtë në këtë

sfidë, që e ngritën në dhjetëminutëshin e fundit, duke shkuar drejt fitores dhe kështu ndodhi, duke fituar me gjashtë pikë dallim 64:70 dhe u renditën të 15-tat nga 18 kombëtare në këtë garë. Ndaj Armenisë u dalluan Agnesa Rrahmani me 31 pikë dhe shtatë kërcime dhe Diellza Dekaj me 14 pikë e 11 kërcime.




Kuçi rikthehet te Dukagjini

KLINË, 17 KORRIK - Rinor Kuçi është përforcimi i radhës për skuadrën e drejtuar nga Armend Dallku. Pas një gjysmë-sezoni të kaluar te

Istogu, mbrojtësi anësor është rikthyer sërish te skuadra nga Klina. Klubi nga Klina ka njoftuar këtë të diel për arritjen e

marrëveshjes me 25-vjeçarin. Rinor Kuçi është përforcimi i pestë zyrtar deri më tani. Dukagjini më herët zyrtarizoi

transferimin e Egzon Qerimit, Dior Zabërgjes, Granit Buqincës, si dhe rikthimin e Mhill Grabanicës.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05n.748 datë 15.07.2022

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2015 (Normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional), UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2022/2023

1. SHFMU "Vaso Pashë Shkodrani" në Leshan

➤ Një mësimdhënës/e për lëndën e historisë

2. SHFMU "28 Nëntori"-Dobërdelan

➤ Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe

3. SHFMU "Ramë Bllica"-Bllicë

➤ Një mësimdhënës/e për lëndën e biologjisë (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
➤ Një mësimdhënës/e për lëndën historio-edukatë qytetare (për kohë të caktuar deri në përfundimin e mandatit të drejtorit)
➤ Një mësimdhënës/e për lëndën e fizikës për 10 orë (për kohë të caktuar deri në përfundimin e mandatit të drejtorit)

4. SHFMU "Sadri Duhla"-Duhël

➤ Një mësimdhënës/e të mësimi klasi (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

5. SHFMU "Dëshmorët e Greikocit"-Greikoc

➤ Një mësimdhënës/e për lëndën e muzikës me plotësim orësh në shkollat tjera (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

6. SHFMU "Besim Ndrecaj" në Maçitevë

➤ Një mësimdhënës/e të mësimi klasi

7. SHFMU "Hasan Prishtina"-Semetišt

➤ Një mësimdhënës/e të mësimi klasi (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

8. IP "Fluturat" – Suharekë

➤ Një edukator/e për paralelen në Mushtisht (zëvendësim i pushimit të lehonisë)
➤ Një edukator/e për paralelen në Studenčan (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

9. IAAP "Skënder Luarasi"-Suharekë

➤ Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane për 11 orë
➤ Një mësimdhënës/e për lëndët e elektroteknikës
➤ Një mësimdhënës/e për lëndët dizajn i tekstilit dhe veshjeve për 15 orë

10. IAAP "Abdyl Ramaj"-Shirokë

➤ Një mësimdhënës për lëndët e mjekësisë për 10 orë
➤ Një bashkëpunëtor për lëndët e infermierisë për 10 orë praktik profesionale
➤ Një bashkëpunëtor për lëndët laborant mjekësor për 10 orë praktik profesionale.

Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.05/2021 dhe normativit UA-MASHT nr.05/2015 Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI (nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data 18.07.2022 deri më date 01.08.2022.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br.748 od 15.07.2022 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068, Al br.05/2021 (Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU br.05/2015 (Normativa za nastavnike stručnog obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru, Opština direkcija za obrazovanje objavljuje:

KONKURS

Za popunu slobodnih mesta za školsku godinu 2022/2023

1. OSNŠ "Vaso Pashë Shkodrani"-Leshane

➤ Jedan nastavnik/ca za predmet istorije

2. OSNŠ "28 Nëntori"-Dobërdelan

➤ Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika

3. OSNŠ "Rame Bllicaa"-Bllicë

➤ Jedan nastavnik/ca za predmet biologije (Zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

➤ Jedan nastavnik/ca za predmet istorije- gradansko vaspitanje (do zaveršetka mandata direktora škole)

➤ Jedan nastavnik/ca za predmet fizičko vaspitanje za 10 časova (do zaveršetka mandata direktora škole)

4. OSNŠ "Sadri Dula"-Dule

➤ Jedan nastavnik/ca za razredu nastavu (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

5. OSNŠ "Deshmoret e Greikocit"-Greikoc

➤ Jedan nastavnik za muzičkog vaspitanja sa dopunom časova u drugim školama (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

6. OSNŠ "Besim Ndrecaj"-Maçiteve

➤ Jedan nastavnik za razredu nastavu

7. OSNŠ "Hasan Prishtina"-Semetište

➤ Jedan nastavnik/ca za razredu nastavu (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

8. Dečji vrtić "Fluturat" –Suva Reka

➤ Jedan vaspitačicu za odelenju u Studenčane (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

➤ Jedan vaspitačicu za odelenju u Muštište (zamena za nastavnicu porodiljsko odsustvo)

9. IAAP "Skender Luarasi"-Suva Reka

➤ Jedan nastavnik za predmet nemačkog jezika za 11 časova

➤ Jedan nastavnik za predmet elektrotehnike

➤ Jedan nastavnik za predmet dizajn tekstila i modeliranje odeća za 15 časova

10. IAAP "Abdyl Ramaj"-Širokë

➤ Jedan nastavnik za medicinski predmet za 10 časova

➤ Jedan nastavnik za profesionalnog praksa infermierie za 10 časova

➤ Jedan nastavnik za profesionalnog praksa za medicinska laboratorije za 10 časova

Uslovi: Za ova slobodna radna mesta obavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021, AU MONT br.05/2015.

Dokumentacija potrebna za konkurs:

-Obrazac (prijava) kokandidat popunjava

-Ekstrakt rođenja

-Lična karta (fotokopija)

-Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)

-Dokaz da nije pod istragom

-Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)

- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano, dok će se originalni dokumenti predstavljavati u intervju.

Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.

Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od 18.07.2022 do 01.08.2022

Orasporedu intervju bićete obavesteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

Direktor profete
Remzi Bajselmani





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

